



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.76/2016

Prishtinë, më 01.11.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Glauk Konjufca, zëvendëskryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Mungoi: Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar.

I ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik

Pjesëmarrës të tjerë: Halit Hoxhaj, Nazmi Zenelaj, Vllaznim Krasniqi, Leonora Makolli – MZHE, Dardan Abazi – INDEP, Rinora Gojani – KOSID, Etleva Malushaj – LVV dhe Fjolla Uka – KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.10.2016;
3. Raportim i z. Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioriteteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.10.2016

Procesverbali nga mbledhja e datës 25.10.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i z. Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për zhvillimet në fushëveprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioriteteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm

Blerand Stavileci, ministër i Zhvillimit Ekonomik, paraqiti para deputetëve objektivat e ministrisë, realizimin e prioriteteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm. Ministri ka shpалosur të arriturat në fushat e energjisë, minierave, ndërmarrjet publike dhe fushave të tjera që mbulon Ministria e Zhvillimit Ekonomik, që ai e drejton. Me këta rast ministri Stavileci i ka njoftuar anëtarët e Komisionit për miratimin e ligjeve në sektorin e energjisë, të cilat sipas tij do t'i hapin rrugë një zhvillimi të sigurt ekonomik.

Me këtë rast për ministrin u shtruan pyetje dhe u ngritën disa çështje nga anëtarët e Komisionit, si **Muhamet Mustafa, Sala Berisha – Shala, Blerim Grainca, Enver Hoti, Glauk Konjufca, Rrustem Berisha, Raif Qela, Duda Balje, Besim Beqaj dhe Fatmir Rexhepi**, të dhëna në transkript pjesë e këtij procesverbal.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZHE), që në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe kompetencat, të marrë masat si vijon:

- 1. Të procedohet Strategjia e Energjisë në Kuvend, të përgatitet ligji i ri për Ndërmarrjet Publike dhe të dërgohet në Komision një raport për orientimet në zhvillimin e sektorit minerar;*
- 2. Të themelohet një grup pune për zbatimin e ligjit për Trepçën, duke përfshirë të gjithë aktorët relevantë, në mënyrë që të mos krijohen vakume në zhvillimin e Trepçës;*
- 3. Raporti i performancës për ndërmarrjet publike për vitin 2015, të procedohet sa më shpejt në Kuvend, dhe të jetë më gjithëpërfshirës. Si pjesë përbërëse e raportit të performancës ose si raport i veçantë të raportohet me shkrim për zbatimin e kontratave për ndërmarrjet publike të privatizuara apo të koncesionuara;*

5. Në bazë të studimeve dhe planeve të dekomisionimit dhe ndërtimit për Kosovën A, Kosovën B, Kosovën e Re dhe TAP-in, të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për menaxhimin e boshllëkut (GAP-it) eventual që mundet me ndodhë në furnizimin me energji;

6. Të ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e interesave ekonomike të Republikës së Kosovës në raport me Serbinë, siç është aspekti i Kodit telefonik, aspekti i KOSTT-it, si dhe aspektet e tjera.

4. Të ndryshme

Çështjet vijuese:

a) Projektligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë

Kryetari: Kam kërkuar prej administratës të na sqarojnë se si ka mbetur çështja e këtij projektligji, dhe ata kanë thënë që Qeveria e ka tërhequr nga rendi i ditës në seancë plenare, por jo nga Kuvendi.

Lidhur me këtë, kryetari propozoi:

Te sqarohet nga Kryesia e Kuvendit, procedura e tërheqjes nga rendi i ditës në seancën plenare të datës 10.3.2016, Projektligji për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë, dhe mundësisht ky projektligj të futet në rend dite në njërin nga seancat e radhës së Kuvendit, ose të kërkojë Kryesia e Kuvendit nga Qeveria, që të sqarojë pozicionin e saj karshi këtij projektligji.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit.

b) Punëtorja dhe takime me biznese

Kryetari theksoi se pas vizitës së Agjencive të pavarura, të shohim që të vizitojmë bizneset e caktuara, nga të cilat kemi disa ftesa, që të shihen si po ndikojnë reformat ekonomike. Lidhur me këtë kryetari theksoi se do të ishte mirë të organizojmë një punëtori, ku do t'i ftonim të gjithë përfaqësuesit e komunitetit të biznesit që të shikojmë këndvështrimet e bizneseve lidhur me masat fiskale që janë marrë, investimet dhe mjedisin biznesor. Kryetari, njoftoi anëtarët e Komisionit se ka një ftesë nga fabrika e miellit M-SILLOSI në Xërxë për ta vizituar, kush është i interesuar prej deputetëve mundet të bashkëngjitet, vizita do të realizohet nesër.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit për mbajtjen e një punëtorie me komunitetin e biznesit dhe vendosi që të fillohet me përgatitjet.

c) Vizita e Komisionit homolog nga Kuvendi i Shqipërisë

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit, se nga data 10 deri më 12 nëntor 2016, do të vijjnë për vizitë komisioni homolog nga Kuvendi i Shqipërisë, ku do të mbajmë një mbledhje të përbashkët më 11.11.2016. Kryetari kërkoi nga deputetët që t'i japin ndërkohë propozimet për temat të cilat do të duhej të diskutoheshin në këtë takim. Si tema ai përmendi tregtinë mes dy vendeve, projektet kapitale, interkoneksioni dhe tema të tjera sipas interesit të përbashkët.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa

MUHAMET MUSTAFA kryetar i Komisionit, ia dha fjalën ministrit për të raportuar para Komisionit.

BLERAND STAVILECI, Ministër i Zhvillimit Ekonomik: faleminderit zoti kryetar.

Përgjatë vitit 2016 janë zhvilluar aktivitete të shumta. Për Zhvillimin e sektorit të energjisë janë miratu ligjet e sektorit të energjisë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës: Ligji për Energjinë Nr 05/L-081, Ligji për Energjinë Elektrike me nr. 05/L-085, Ligji për Rregullatorin e Energjisë Nr 05/ L- 084, Ligji për Gazin natyror me Nr. 05/L- 082. Ligji për Eficiencën e Energjisë – është draftuar dhe pritet të përfundoj përgjatë vitit 2017. Ka fillu aktiviteti për nxjerrjen e legjislacionit sekondar që dalin nga pakoja e ligjeve të energjisë. Strategjia e energjisë e Republikës së Kosovës 2016-2025, është draftuar strategjia, janë zhvillu diskutime me akter relevant dhe janë zhvillu diskutime publike. Përmbyllja e projekteve të vitit 2016 (projekti i fushatës publike për EE dhe BRE si dhe programi mbështetës – auditimi i energjisë në objektet publike) vazhdojnë edhe për vitin 2017). Ndërtimin i Termocentralit Kosova e Re - Për shkak të specifikave dhe volumit të madh të marrëveshjeve që duhet arritur, bisedimet për mbylljen e fazës së parë të projektit “Mbyllja Komerciale” kanë vazhduar intensivisht dhe tani nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve do të behet nga mesi i K4 2016. Njëkohësisht po punohet në përgatitje të finalizimit të fazës së dytë të projektit “Mbyllja financiare”, e cila pritet të kryhet në K1-2017. Studimi i Fizibilitetit për Rehabilitimin e TC Kosova B - Projekti për Studimin e fizibilitetit për Rehabilitimin e TC Kosova B është duke u zhvilluar sipas planit. Pritet të përfundoj kah mesi i vitit 2017. Ngritja e Eficiencës së Energjisë në objektet publike -Janë përgatitur dizajnet për 14 ndërtesat e planifikuara si dhe është bërë tenderimi me rregulla të BB (përmes kredisë nga BB). Shpejto pritet përzgjedhja e kompanisë për Implementim të projektit. Gjate vitit 2016 janë shpenzuar rreth 497550€ (periudha Janar-Shtator), ndërsa deri në fund të vitit pritet që të shpenzohen edhe 830000€. Procesi i dekomisionimit të objekteve të azotikut, gazifikimit dhe ngritjes në lokacionin e TC Kosova A – aktiviteti është duke u zhvillu në përputhje me vendimin e Qeverisë Nr. 04/156. Është analizu legjislacioni, është përgatit specifikacioni teknik i objekteve si dhe janë identifikuar dhe sistemu projektet teknike të këtyre objekteve.

Për zhvillimin e Sektorit Minerar janë realizuar miratimi i Programit të zbatimit të Strategjisë Minerare 2015-2017, hartimi i Raportit të Progresit për vitin 2015 për zbatimin e Strategjisë Minerare, miratimi i Planit të Menaxhimit të Resurseve minerale për vitin 2016, në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Zhvillim ekonomik, Infrastruktura, Tregti dhe Industri është hartuar dhe miratuar ligji Nr. 05/L-062 për Siguri në punë në veprimtarinë minerare, është miratu Ligji për Trepçen. Përcjellja e realizimit të marrëveshjes për përkrahje të Ndërmarrjes Trepça në këto projekte për vitin 2016: riaftësimi i vend punishteve në horizontet VIII dhe IX Miniera TREPÇA Stanterg në vlerë 700,000 euro, hapja e vendpunishteve të reja në horizontet X-XI Miniera TREPÇA në vlerë 635,000 euro, përmirësimi i kushteve të punës në Rafinerinë – Zveqan në vlerë 400,000 euro, mbështetja e ndërmarrjes Trepça- AKP përmes subvencioneve për pagimin e pagave dhe stipendioneve për puntorët e Trepçës në vlerë 3,082,870 euro. Studimi lidhur me identifikimin e efekteve anësore të aktiviteteve minerare në komunitet në vlerë 50,000 euro, në fazën e realizimit përfundimtar. Funkcionalizimi i Laboratorit të Gjeologjisë, faza e dytë - furnizimi i laboratorit gjeologjik me pajisje në vlerë financiare prej 2016 550.000,00 €. Përpilimi

i hartës (planshetit) gjeologjike në shkallë 1: 25000- projekti është në fazën përfundimtare. Përpilimi i projekteve dhe pasaportave për zonat me interes të veçantë - Është bërë realizimi i pasaportës për zonën me interes të veçantë Devë, Golesh dhe Bresalc. Monitorimi i ngjarjeve sizmike dhe gjeorrezive - Është bërë evidentimin e zonave të gjeorrezive në terren, krijimin e hartave dhe digjitalizimin e tyre në të gjitha zonat që janë shfaqur këto dukuri.

Në Sektorin e TIK-ut janë bërë Dokumenti i Strategjisë Nacionale për Teknologji Informative është miratuar me Vendimin Nr.14/67 të Qeverisë, e cila përmban planin e detajuar të veprimit për periudhën 2016-2018. Ka filluar të zbatohet. Projektet me Bankën Botërore si Programi i Ekonomisë Dixhitale të Kosovës – KODE (Kosovo Digital Economy Program) dhe Zbatimi i Programit për Ekonominë Dixhitale të Kosovës - KODE ku përfshinë shtrirjen e infrastrukturës brezgjere me shpejtësi të lartë (high-speed broadband infrastructure deployment) në zonat rurale. Kosto e planifikuar 37 Milion €, e shpërndarë gjatë viteve 2017-2019, zhvillimin e resurseve njerëzore për Ekonominë Dixhitale dhe Mbështetjen për bizneset dixhitale (ICT skills development and supply and support to digital businesses). Kosto e planifikuar 3 Milion €, të shpërndarë gjatë viteve 2017-2019. Pilot Projekti Gratë në Punët Online (Ëomen in Online Ëork) – ËOË është realizuar në dy komuna Lipjan dhe Gjakovë. Ka fillu Pilot Projekti Gratë në Punët Online (Ëomen in Online Ëork) – ËOË 2 - Ky pilot përfshin trajnimin e së paku 65 grave të ndara në tri grupe/module të ndryshme për trajnim dhe përfshin rajonin e Prishtinës.

Monitorimi i ndërmarrjeve publike. Ngritja e kapaciteteve të anëtareve të bordeve të ndërmarrjeve publike - MZHE në bashkëpunim me IFC, ka organizuar trajnimin e Bordeve të Drejtoreve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore. Trajnimi me temën: Praktikat më të mira ndërkombëtare të Qeverisjes Korporatave në ndërmarrjet shtetërore është mbajtur në katër grupe, nga data 14-17 Qershor 2016. Zbatimi i politikave të Qeverisë përmes përkrahjes financiare nga buxheti i Kosovës për ndërmarrjet publike.

Përgjatë vitit 2017 planifikohet për Sektorin e Energjisë: Kompletimi i legjislacionit sekondar në fushën e energjisë që rrjedhin nga pakoja e ligjeve të energjisë. Vazhdimi i aktivitetit lidhur me TC Kosova e Re. Zhvillimi dhe kompletimi i programit të zbatimit të strategjisë së energjisë. Përmbyllja e projekteve për vitin 2017 (projekti i fushatës publike për EE dhe BRE si dhe programi mbështetës – auditimi i energjisë në objektet publike) si dhe atyre që janë pjesë të KASH-it 2017-2019. Krijimi i ONE stop shopit për BRE dhe Projekte sipas rregullores 347 të KE. Zhvillimi i procesit të procesit të dekomisionimit të objekteve të azotikut, gazifikimit dhe ngrohtores në lokacionin e TC Kosova A – pritet mbështetja me asistencë teknike në kuadër të IPA 2014, Zbatimi i masave të Efiçencës së Energjisë dhe Burimeve të rinovueshme të financuar nga BB - pritet të përgatiten dizajnet për 14 ndërtesat në të cilat do të zbatohen masat e EE përgjatë vitit 2017, ku planifikohet të shpenzohen, rreth €4.4 Mil.

Sektorin Minierar: Hartimi i Raportit të Progresit për vitin 2016 për zbatimin e Strategjisë Minerare. Shqyrtimi dhe Miratimi i Planit të Menaxhimit të Resurseve për vitin 2017. Nxjerrja e akteve nënligjore që dalin nga ligji për Siguri në punë në veprimtarinë minerare. Përcjellja e realizimit të marrëveshjes për përkrahje të Ndërmarrjes Trepça në projektet për vitin 2017.

Realizimi i Studimit për "Prurjet vjetore te inerteve nga lumenjtë kryesor të Kosovës" parashihet te realizohet gjatë vitit 2017-2018 ne vlerën prej 200,000.00 euro. Funkcionalizimi i Laboratorit të Gjeologjisë faza e tretë. Përpilim i hartë (planshetit) gjeologjikë në shkallë 1: 25000. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare, posaçërisht bashkëpunimi me Shërbimin Gjeologjik te Shqipërisë dhe Shërbimin Gjeologjik të Maqedonisë.

Sektori i TIK: Për vitin 2017 parashihet që të realizohen projekte të veçanta për zbatimin e Strategjisë së Kosovës për TI si dhe ato që derivojnë nga Programi i përpiluar në bashkëpunim me Bankën Botërore për Ekonominë Dixhitale të Kosovës,

KRYETARI: Ju faleminderit ministër për këtë raport të përqendruar në çështje më të rëndësishme, ku neve çështjet operative teknike më së paku na interesojnë. Raportimi i juaj është një front i gjërë i çështjeve më të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës dhe po pajohem me ju se janë bërë disa depërtime mjaft të rëndësishme disa projekte që me vite kanë qenë problematike ku ka pasur pak rezultate në realizimin e tyre unë kisha dashur pak që në rundin e dytë pak a shumë që të ndalemi në disa çështje që janë po aq të rëndësishme që të shkojmë deri në fund të zbatimit të tyre.

Tek Trepça është mirë që të krijojmë një lloj grupi koordinues me Trepçën, Kuvendin, Qeverinë dhe me akter tjerë po ashtu edhe me AKP-në ku për çdo ditë t'i përcjellim zhvillimet atje në mënyrë që Ligji për Trepçën sa ma shpejtë të zbatohet.

Ka qenë edhe një studim filizibiliteti në Kosovën A, se çka ka ndodh sa e di unë atë e ka bërë KEK-u, cilat janë rezultatet e atij studimi edhe dhe çka do të bëjmë me të. Për Kosovën e Re meqenëse ju thatë se do të vjen edhe një raport më i detajzuar por nuk do kishte qenë keq që në vija të trasha të na spjegoni se ku janë ato marrveshje dhe a keni depërtuar me ato "Bild Operate Transfer" me atë idenë që biseduam bashkë para disa ditëve sepse ajo është shumë me rëndësi të dihet ne qoftë se arrihet një marrëveshje e tillë.

Tek çështjet e Minierave më vjen mirë që do të përcaktohem tani kur e kemi edhe mbikëqyrjen e Ligjit por edhe në përgjithësi të shohim që Minierat t'i bëjmë një faktor të cilat i kontribuojnë zhvillimit të Kosovës që Kosova të merr strategjinë që burimet natyrore të shëndrrohen në bekim të zhvillimit edhe aty që sigurisht do të punojmë edhe në ndonjë mbledhje të veçantë lidhur me këtë çështje ku do ta trajtojmë zbatimin e Ligjit por duket se gati e keni raportin, dhe atëherë e shohim këtë që e kemi bërë me Trepçën lidhur me tantimën ndaj komunitetit, të shohim a do ta ndjekim këtë shembull në të gjitha rastet lidhur me tantimën për komunitetin.

Një problem që më duket që na ka mbetur pak a shumë të gjithëve pezull janë ndërmarrjet publike, janë një çështje ku na duhet të shohim funksionimin dhe punën e tyre natyrisht që na si Komision dhe Kuvend jemi në ndërhyrje indirekte por jemi shumë të interesuar sepse ato përmbajnë një sektor mjaft shumë të rëndësishëm, deri më tani nuk kemi qenë të kënaqur me raportimin, strukturën e raportit informatat. Ne e kemi bërë edhe një plotësim të Ligjit për ndërmarrje publike, ku i kemi caktuar disa kriteret me të cilat duhet të matet performanca e bordeve, kriteret pak më të

përpunuara se përpara. Ne ende nuk e kemi pa raportin e vitit 2015 për këto ndërmarrje, shpresoj ta shohim sa ma shpejtë, sepse nuk kish qenë mirë vitin 2017 me e trajtuar raportin e vitit 2015, kështu që besoj se ai është gati, duhet të kalojë në Qeveri e të vjen te na por ju kisha sugjeru të përshpejtohet edhe të lexohen ato vërejtje që i kemi pasur në raportet e mëpërparme në mënyrë që raporti tash kur vjen këtu t'i përmbajë të gjitha informatat të cilat ne do të shohim performancën e ndërmarrjeve publike. Këtu e kisha pak a shumë një porosi sepse në tjerat gjëra pothuajse jemi në një vijë. Kemi biseduar edhe diskutuar shpesh por më vjen mirë që do ta bëjmë edhe ligjin e ri për ndërmarrjet publike, ne ju mbështesim edhe mund të them që unë jam më afër konceptit që ndërmarrjet publike të ndërliken me fushat sektoriale ku janë ato, sepse ndërliken më mirë me mbikëqyrjen e atyre ministrive që mbikëqyrin atë fushë të caktuar, më afër infrastrukturës, e kështu të ngjashme, por kur vjen ligji do ta shohim. Mirëpo, ju kishim inkurajuar që ta thelloni këtë alternativë që e keni filluar me punuar, se duket që mund të jetë një alternativë më e mirë por edhe anëtarët tjerë të Komisionit kur të na vjen ligji do t'i shohim dy opcionet.

Është shumë me rëndësi kjo ekonomia digjitale, ju inkurajojmë që në ekonominë digjitale, edhe neve të na inkuadroni, ne do të ju mbështesim maksimalisht. U bë depërtimi drejt ekonomisë digjitale dhe shoqërisë së informacionit.

Strategjia e energjisë presim të na vjen sa ma shpejt, mirë që është dërguar në Qeveri, besoj që do të na vjen te ne. Me këto vërejtje hyrëse edhe komente që do të na jepni shtesë në rundin e dytë, pasi të diskutojnë edhe anëtarët tjerë unë kisha dashtë me ja kalu fjalën deputetëve.

SALA BERISHA – SHALA: Përshëndetje për ministrin Stavileci dhe ekipin e tij, e përgëzoj për një punë jashtëzakonisht të mirë që është duke e bërë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik. I përcolla në mënyrë telegrafike të gjitha që i thatë ju, po unë do të fokusohem te gjeologjia te Shërbimi Gjeologjik, u përmend se i keni në plan planshetat, u përmend funksionalizimi i laboratorit gjeologjik që më vjen shumë mirë. E dimë të gjithë se Shërbimi gjeologjik ka problem me hapësira të punës dhe besoj që i keni projektu këto probleme në buxhetin e vitit 2017. Më vjen mirë që keni mendu tash edhe për përpilimin e programit për zbatimin e strategjisë. Ju uroj për hyrjen në fuqi të ligjit për Trepçën dhe ky ligj të jetë sa më i zbatueshëm dhe sa më funksional. Kisha dëshiruar me ju sugjeru, më vjen mirë që i keni dhënë rëndësi edhe seizmikës, gjeologu është një psikolog i tokës andaj duhet që ajo të trajtohet me prioritet edhe sizmologjia si pjesë e gjeologjisë. Pyetja ime është e shkurtë kisha dashtë me ditë se a do ta përfshini draftimin e një ligji të ri për miniera dhe minerale strategjinë legjislativë për vitin e ardhshëm 2017? Ne tani jemi në përfundim të monitorimit të zbatimit të ligjit për minierat dhe minerale, dhe gjatë punës së grupit punues kemi detektuar disa çështje të cilat duhet të jenë pjesë e ligjit, disa mangësi dhe disa zbrastësi që i ka ligji, ne do t'i adresojmë të gjitha në Komision dhe në seancë parlamentare do t'i rekomandojmë juve si Qeveri apo ndoshta në diskutimet e mëtutjeshme ta iniciojmë ne ta bëjmë një ligj për minierat dhe mineralet apo si i keni planet ju, kjo është pyetja ime kryesore. Faleminderit!

KRYETARI: Para se ta merr fjalën dikush tjetër, ju kisha lutë që mos ta kërkojmë zgjidhjen te ligjet e reja, të shohim ku është problemi me zbatim të ligjeve sepse ne ma problem e kemi me

ndërtu kulturën e zbatimit të ligjit sesa me kriju ligje të reja, kur ka nevojë ne nuk do t'i ikim natyrisht, sikur kjo çështja e ligjit për ndërmarrjet publike, janë bërë disa herë plotësime ndoshta është më mirë me bërë një tekst integral me i zgjedhe edhe disa probleme për të cilat edhe ministri ka fol ma herët dhe foli sot.

BLERIM GRAINCA: Faleminderit zoti kryetar. Përshëndetje për ministrin dhe ekipin e tij. Unë përgëzoj ministrin për të gjitha të arriturat që i listoi këtu, i përmendi, duke filluar prej strategjive, ligjeve dhe së fundi ligjin për Trepçën, që është një punë e përbashkët e të gjitha institucioneve. Do të ngris dy apo tri çështje që mendoj se janë me interes për me i diskutuar.

Po filloj nga ajo e fundit që e përmendi edhe kryetari, çështja e ndërmarrjeve publike. Ne shpeshherë këtu kemi dhënë vërejtje për performancën e bordeve por edhe menaxhmentit të ndërmarrjeve publike dhe nga krejt ajo që po arrijmë të shohim është se kjo performancë nuk po përmirësohet dhe këto kompani janë shëndrru si pengesë politike më shumë sesa kompani që ofrojnë shërbime kualitative për qytetarët e vendit tonë. Mbi të gjitha po ekziston një opinion se këto kompani janë shëndrruar në mekanizëm për punësim të militantëve partiak e që realisht unë mendoj më shumë do t'i shkonte punësimit të familjarëve të caktuar sesa për kuadro dhe njerëz që do të mundësonin një zhvillim më të mirë. Andaj mendoj që edhe kësaj çështje zoti ministër duhet të kishim më shumë kujdes dhe për performancën e përgjithshme të bordeve të këtyre kompanive dhe performancën financiare edhe të vet këtyre kompanive dhe menaxhmentit të tyre.

Më intereson edhe për disa projekte të cilat ministri, me sa arrita unë me i përcjellë nuk i përmendi, më intereson çështja e kontratës për Kosovën e Re, deri ku ka arrite zoti ministër, çka po ndodh me të, a do të fillojë së shpejti, a ka pengesa, a është investitori akoma në nivel të performancës së mirë financiare për të përballuar këtë projekt dhe kur mendon se do të fillojë së realizuari.

Poashtu më intereson pse nuk po vëhet në funksion transmisioni, që të gjithë i kemi thënë autostrada energjetike Kosovë – Shqipëri, cilat janë problemet, a janë probleme të natyrave teknike, a janë probleme të natyrave politike, apo janë probleme të tyre komerciale sepse ne jemi deputet dhe shpeshherë na vijnë informatat të natyrave të ndryshme nga burime të ndryshme deri te ato që kjo bëhet për të mundësuar shitjen e energjisë operatorëve të caktuar në Kosovë, të energjisë që vie nga importi.

Edhe e fundit ajo çka më intereson është a ka bërë Ministria gjegjësisht Qeveria ndonjë studim për mundësitë e lidhjes me gazsjellësin TAP, për efektet që mund të ketë në ekonominë kosovare, dhe a ka mundësi që kjo çështje të futet në funksion sa ma shpejtë, cilat janë përpjekjet që po bënë Ministria, cilat janë problemet që ka, a janë të natyrës teknike, a janë të natyrës financiare, a ka gatishmëri sepse në disa takime që ne kemi pasur qoftë zyrtarisht qoftë privatisht me kolegët tanë të parlamentit të Shqipërisë nuk po na përputhen këto agjendat nacionale. Këto janë zoti ministër komentet që kam.

ENVER HOTI: Përshëndetje për ministrin dhe stafin e tij. Ndoshta ka qenë mirë që ministri diçka me shkrim me pasë sjellë, por bëhet praktikë më vonë. Ne dëgjuam ministrin me vëmendje, do të kishim pasë dëshirë të dëgjojmë ndonjë perspektivë, ku gjindet qe dy vite, çka kanë bërë, çka kanë arritë, ne dëgjuam vetëm se jemi në hartim të disa strategjive, në hartimin dhe planifikimin e disa ligjeve sikurse nuk ka ekzistuar asnjë ligj deri më tani, sikurse edhe nuk ka pasë asnjë strategji për zhvillim deri më tani. Kjo është një pasqyrë jo e mirë për neve jo e dëshirueshme edhe më e dëmshme është për qytetarët e vendit.

Po vazhdoj ministër, do të thoja një gjendje e vështirë në ndërmarrjet publike, këtu ende po vazhdon mosrespektimi i parimeve të qeverisjes korporatave në procesin edhe të përzgjedhjes së bordeve edhe të menaxhimit të tyre edhe në aspektin e menaxhmentit në ekzekutiv, dhe po më vjen mirë që kanë fillu në disa eksponent të pushtetit të cilët nuk po mundën me i realizuar ndoshta punësimet nëpër ndërmarrjet publike kanë arritë me ndal punësimin e militantëve partiak në ata familjar. Së paku kështu i sheh opinionin ndërmarrjet publike sepse ato jo që janë shëndrru në punësim por janë shndërrua në një strehë pa kurrfarë mbulese të një numri enorm të punësuarëve, pa kurrfarë kriteri dhe pa shpresë dhe pa perspektivë që ndërmarrjet publike të realizojë një qeverisje korporatave për të cilën edhe janë të obliguar dhe të krijuar. Këtu nuk ka asnjë dyshim se edhe pse jeni ardhë ju tash ministër edhe qeverisja paraprake tani po vazhdon një gjendje jashtëzakonisht e rëndë. Kam edhe një pyetje direkte për ndërmarrjet publike, si përmbledhje gjendja po vazhdon, po shihet që nuk keni fuqi me ndërmarrë kurrgjë, mund të shprehi mirëkuptimin tuaj por nuk ke fuqi edhe kapacitet politik me i përballu shefat e tu për ato që ndodhin në ndërmarrjet publike, edhe me dasht Blerand nuk mundesh.

Kjo tjetra, po dua të pyes a ke ndonjë informacion rreth incidentit që ka ndodh më 2014 në KEK, na ka pasë kushtu mjaft shumë ajo avari edhe në situatat politike edhe në situatat e, e di që pjesë e hetuesisë edhe e policisë e sistemit të drejtësisë por a keni diçka ndonjë raport se cilët kanë qenë shkaktarët sepse kostoja ka qenë bukur e lartë në të gjitha çështjet edhe të sigurisë edhe në aspektin politik edhe në aspektin financiar. Ka kalu kohë e gjatë, së paku ndoshta keni njohuri çka ka ndodhë, apo mundet me ndodhë përsëri nëse heshtim ashtu.

Për strukturën e re që e paraqite për ndërmarrjet publike nuk e di nuk kam kurrfarë pikëpamje ndoshta është herët me fole, ndoshta nuk po doni me i lënë nëpër ministri edhe me i nda se po jiti keq për përcaktimin e drejtorëve edhe anëtarëve të bordit, sigurisht doni mi nda sipas ministrive por do të presim, shpresoj të jetë më mirë por jam kogja shumë në dyshim. Faleminderit!

GLAUK KONJUFCA: Atëherë unë desha të filloj nga ajo që mendoj se është më e rëndësishmja dhe nuk dëgjuam asgjë nga ministri që ka të bëjë me temën që tani u ngrit besoj se i ka dy muaj nuk janë bërë ende ndoshta me përpjekjen e Envidity që te vijë në Kosovë një planë shumë të pa hollësishëm do të thoja. Ka pretendime dhe ambicie që në Kosovë të zhvillojë një aktivitet i cili është kogja serioz për shtetin tonë dhe për prespektivën në përgjithësi të sektorit edhe të energjetikes edhe minerale në përgjithësi. Pra po flitet për një korporatë e cila ka filluar prej vitit 2013 të interesohet për këtë fushë mirëpo shpjegimin e tyre që e kam lexuar edhe vet një raport i

cili është dorëzuar në institucionet e Kosovës aty kam vërejtur që në të vërtetë që këtu nuk është thelbi te hulumtimi fare këtu është qëllimi përfundimtar i kësaj korporate është shfrytëzimi i bazeneve të thëngjillit, por aty siç thuhet dy procese që është gazifikimi dhe lëngëzimi i thëngjillit prej cilit pastaj krijohen derivatet të tjera dhe bëhet biznes me to. Prej Qeverisë së Kosovës nuk kemi parë asnjë lloj analize asnjë lloj strategjie asnjë lloj shpjegimi të hollësishëm lidhur me këtë qasje të kësaj korporate edhe me projektin e saj, krejt çka kemi parë është vetëm çka ka ofruar ndërmarrja e cila po interesohet për këtë fushë. Sa i përket Qeverisë Kosovës deri në momentin kur është bërë publike kjo kemi dëgju më shumë prej shoqërisë civile sesa prej juve prej Qeverisë së Kosovës, vetëm atëherë kjo çështje e ka marrë dhenë siç thuhet e pastaj kanë filluar debatet shoqërore lidhur me këtë problematikë, pra pyetja ime e parë është kjo.

E dyta ka të bëjë me Contour Global dhe çështja është që është fare e qartë se furnizimi me energji në Kosovë çalon shumë, p.sh. ka rajone të tëra ku reduktimet janë të tmerrshme, dhe parrmbremë kur isha në një fshat të Gjakovës në Krelan dhe prej orës 6 që kishim aty takim në shkollë nuk kishte energji elektrike edhe deri kur përfundoi tubimi ishte ora 8 dikun vazhdonte të mos ketë energji elektrike. Ka shume rajone ashtu në Kosovë dhe tash cila është ajo perspektiva vizioni i Qeverisë qysh me pasë furnizim me energji elektrike, qysh me u shpëput prej këtij importi i cili na ka kushtu shumë edhe i cili po vazhdon i energjisë elektrike, është që të sillt një investitor në Kosovë, Kosova e Re krejt këto projekte që i ka Qeveria, mirëpo halli i qytetarëve, i shoqërisë civile por edhe i neve që jemi të zgjedhur edhe që pretendojmë me i mbrojtë interesat e atyre që na kanë zgjedhë edhe që janë qytetarë të Kosovës. Në rregull është ky shqetësimi i Qeverisë për me sjellë investitorë edhe për me ngjallë furnizimin me energji elektrike, por në anën tjetër disa institute të shoqërisë civile të cilat janë të specifikume me studju këtë çështje kanë ardhë në përfundime që ne do të kemi një ngritje të hatashme të çmimit të energjisë elektrike. Sipas konditave të kontratës, edhe kur konditat e kontratës janë përkthyer në koston minimale që investitorit i konvenon me ardhë në Kosovë me prodhuar energjinë elektrike dhe me na e shitë neve është siç po thuhet një kosto së paku 50% e ngritjes së çmimit të energjisë elektrike pasi të përfundojë ky projekt. A shqetësohet Qeveria edhe për këto lloj problemesh apo shqetësimi kryesor i Qeverisë është vetëm sa do të fitojë Contour Global edhe sa po ja rrok atij me pasë profitin. Pra na si institucione ne jemi të zgjedhur së pari për me u shqetësu për çmimin e energjisë elektrike pastaj e dyta është sesa fiton Contour Global. T'i shqyrtojmë të gjitha alternativat, nëse është shumë shtrenjt a ka mundësi ma lirë, krejt duhet me u studiu.

E treta, e ngriti edhe zoti Grainca lidhur me interkoneksionin, a është, tash kanë mbet edhe dy muaj prej që ju keni thënë se ka afat Serbia për me zgjidh bllokadën e saj që e ka shkaktuar, si quhej ai institucioni që ishit në tetor Këshilli i ministrave të energjetikës, në Traktat. Aty në Traktat sa po më kujtohet deklaratat e asaj kohe të juaja kanë qenë që këtu përgjegjësi kryesor është Serbia, me shkeljen e atij nenit 8 të Traktatit, edhe bllokada vjen prej Serbisë. A e keni ngritë ju këtë çështje, a jeni ankuar edhe te faktorët ndërkombëtar lidhur me këtë çështje sepse në një rën anë po proklamoni normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, nuk po them për ty personalisht, por për Qeverinë për ata që e udhëheqin këtë proces, e në anën tjetër na ndodh me këto sektore që është edhe ky i juaji, Serbia është bllokuese e vazhdueshme e Kosovës, qet probleme të vazhdueshme, dhe nuk e ka thjesht vetëm për këtë çështjen e këtyre simbolikave të

sovrانيتit e kështu me radhë por është edhe çështja e fitimit sepse Serbia do të humbiste shumë nëse kjo do të arrihej edhe nëse për shembull Kosova do të gjente zgjidhje alternative të furnizimit edhe bashkëpunimit me Republikën e Shqipërisë. Kështu që ku qëndron ky aspekt 31 dhjetori po më duket do të jetë ai afati i fundit deri kur pritët me u zgjidh ky problem.

Çështja e katërt, nuk e thatë asnjë fjalë për Aksos-in. Aksosi mendoj që është problemi më i madh që ka ndodhë në Kosovë tri katër vitet e fundit. Pse po e them këtë, sepse më duket një avanturë, ju si ministër nuk e keni drejt përgjegjësinë, i kanë do ma herët para teje, mirëpo ka qenë një aventurë shumë e rrezikshme e cila rrezikon të na shkaktojë një kosto të papërballueshme për buxhetin e Kosovës. Siq e dini ju Aksosi na ka paditë në këtë qendrën International Centre for Supplement of Investment Dispute krejt ato problematikat që janë që lidhen me kontestet të cilat ndodhin sa i përket investitorëve të huaj. Edhe me thënë të drejtën problematika më e madhe që shfaqet në këtë pikë është qysh sa i përket krejt ato që quhen kritere të parakualifikimit, që një investitor me ardhë në Kosovë edhe me ble për shembull PTK-në qysh ndodhi që ato kanë qenë kaç të sakta, edhe ju keni pretendu, kur them ju mendoj Ministria sepse ju nuk keni qenë atëherë që të keni këtë përgjegjësi mirëpo tash jeni. Qysh është e mundshme në atë kohë Qeveria me i ditë krejt këto kriteret e parakualifikimit edhe në fund me dalë që vallah nuk e di ky Aksosi nuk paska pare, nuk paska qenë serioz, na paska rrejt, na paska mashtru hajde ta shkëpusim kontratën në mënyrë të njëanshme, edhe tash kjo ndërmarrje shkon na padit atje edhe kërkon qindra miliona euro prej buxhetit të Republikës së Kosovës. Po ia kujtoj vetëm disa prej atyre që i keni quajtur kritere të parakualifikimit për shmebull a) investitori duhet të jetë ofruer i shërbimeve të telefonisë mobile tri vitet e fundit. Aksosi nuk ka qenë. Aksosi nuk u marrë me telekomunikim, ajo është disa njerëz që bëhen bashkë edhe kanë pare edhe synojnë me ble sene, dhe me siguri për ndonjë investim si lloj makijazhi e me shitë mandej dy treqind milion euro pas pesë apo gjashtë viteve kështu është Aksosi. b) Në tre vitet e fundit të ketë të hyra më shumë se 300 milion euro, kriteri “b” i parakualifikimit që me thënë që Aksosi po investon ki drejt me ble, edhe kjo nuk ka qenë e vërtetë. Ne madje edhe e kemi bërë edhe një hulumtim lidhur me të ardhurat e Aksosit, ajo është kompani fantom, edhe paret e saj janë në një ishull i cili quhet ishulli Kajman që është parajsë e fondeve që grumbullohen aty qëllimi kryesor i të cilave është krijimi i këtyre ndërmarrje “Off Shore” që quhen edhe që shtetet prej të cilave ato vijnë nuk e kanë bazamentin ligjor për me e hulumtu prejardhjen prek kah po vijnë ato para. Kjo domethënë ka paraqitë një problem shtesë qysh Kosova me ra në këtë kurth edhe qysh me ja shit bash një kompani me asi fonde të dyshimta njëherë prej aseteve tona më të çmueshme Posta dhe Telekom i Kosovës. Tash me shumë kollajllëk po interpretohet kjo punë, ne jemi serioz ne i shkëputim kontratat sepse Aksosi nuk paska pare. Mirë po a duhet në këtë vend me dhënë përgjegjësi dikush, a duhet me u siguru me kënd po lidhesh paraprakisht, edhe a është ai në nivel të përgjegjësive të kontratës që e nënshkrun pastaj mos me na ndodhë problemet që po na ndodhin tash. Domethënë kjo është pyetja ime.

Edhe e pesta edhe e fundit. Më është dukur që ministria e juaj nuk është në nivel të përgjegjësive të monitorimit të kontratave të ndërmarrjeve që janë shitur e që bijnë në fushën e juaj. Për shembull çka po ndodh me punëtorët e Aeroportit, çka po ndodh me investimet e kompanisë, për shembull aty janë edhe disa obligime për punëtorë nuk është thjeshtë vetëm sa pare ka me i investuar investitori. Për shmebull çka po ndodh me punëtorët e KEDS-it, është e njëjta sikur me

të aeroportit. Domethënë nëse ka pasë investitori, ka ardhë me premtime të që do të ketë forma standarde të kontratave përmes të cilave punëtorët e kategorive të caktuara do t'i ruajnë vendet e punës dhe tash e shkel atë kontratë, kush duhet me u interesuar për ta. Nëse kjo nuk i bjen Qeverisë në mënyrë gjenerale, i bjen një dikasteri, a është ai dikasteri yt që i bjen kjo përgjegjësi me u interesuar të paktën për këta punëtorë. 332 punëtorë i ka largu prej punës investitori që ka ardhë KEDS-i prej se ka ardhë. Në përgjithësi statistikisht tona janë që prej kur ka ardhë janë larguar nga KEDS-i 332 punëtorë. Tash ata duke qenë që edhe punëtorët janë njëra prej kategorive të cilat duhet me u marrë parasysh interesi i tyre kur merr vendim Qeveria për privatizim apo mosprivatizim të një ndërmarrje ata pajtueshmërinë e tyre duke ia ofruar atyre edhe njëfarë sigurie që vendet e tyre të punës do të jenë të sigurta edhe ajo kompani ai investitor që po vjen duhet ta ketë edhe një interesim për ta për perspektivën e tyre në të ardhmen. Kur ajo këputet totalisht edhe ai nuk të jep kurrfarë llogarie më, ky është oborri jem, prona jem, e qes prej pune këdo edhe përkundër kontratës që e ka nënshkruar, atëherë a i kqyrni ju edhe njëherë kontratat për shembull për investimet të cilat u zotu, në cilat pjesë do të investojë në rrjet, në krejt këto gjërat. Për shembull me u ul me investitorin edhe me i shqyrto krejt nëse dikund ka bërë ai ndonjë gabim në kuptimin që nuk i ka plotësuar krejt kriteret për të cilat ju e keni nënshkruar kontratën, a mundet me pasë penalizime, a ka thirrje në përgjegjësi, a ka llogaridhënie. Në këtë aspekt mendoj që ka çalu dikasteri i juaj.

RRUSTEM BERISHA: Përshëndes ministrin, falënderoj për raportimin. Disa pyetje që kam dashtë me i bërë i parashtruan parafolësit e mi por ajo që po më intereson edhe që e kam bërë pyetje parlamentare në seancë e që nuk e kam marrë përgjigjen ka të bëjë me ushtrimin e veprimtarisë ilegale të operatorëve serb në Kosovë. A keni të dhëna rreth kësaj veprimtarie këtyre operatorëve, sa i kushton kjo buxhetit Kosovës edhe kur do të ndërpritet diçka e tillë, për operatorë të telefonisë është fjala.

Çështja e dytë ka të bëjë me ligjin për Trepçën, ligji u miratu në Kuvend tash edhe Gjykata Kushtetuese e shpalli jo të vlefshëm kërkesën e listës serbe, presidenti e dekretoi këtë ligj. Çka do të bëhet më tutje kur do ta kemi fizibilitetin, kur do ta kemi strategjinë zhvillimore, dhe kur do të fillon me hy në funksion realisht, mos me u ndal vetëm me kaq. Ne nëse mendojmë që metë vërtetë është diçka e mirë që ka ndodh por nuk guxojmë me u pajtu vetëm me atë që e kemi miratu ligjin dhe tash mos me u vendos në funksion këtë ligj sa ma shpejt.

Pyetja tjetër ka të bëjë me KEDS-in, çka po ndodh me KEDS-in, pse po largohen punëtorët prej pune, a është kjo pjesë e marrëveshjes ose kontratës për koncesionimin apo ku qëndron problemi. Për ditë po kemi ankesa, a ka mundësi me e ngritë këtë çështje.

Pyetja tjetër që ka të bëjë me nënshkrimin e marrëveshjes memorandumit mirëkuptimit mes Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës, a ka fillu me u përmirsu komunikimi ekonomik, a ka hapa të përmirësimit diçka më konkret se po vijnë bizneset, shpesh po vijnë dhe po ankohen edhe përkundër nënshkrimit të kësaj marrëveshjes ka ende barriera në shkëmbimin ekonomik. A mund të na njoftoni diçka lidhur me këtë a ka ndonjë përmirësim apo ende vazhdon.

Këto janë disa pyetje pa dashtë me i përsëritë edhe tjerat që i bënë parafolësit e mi. Ju falemninderit!

RAIF QELA: Të nderuar deputet, i nderuar ministër me bashkëpunëtorë. Jemi qe bukur do herë në raportim të ministrit për zhvillimin ekonomik dhe çdo herë kemi hasur në përgjigje adekuate lidhur me pyetjet e parashruara. Unë do t'i parashtoj disa prej çështjeve që besoj se kanë mbetur të pasqaruara.

Duke pasur parasysh se furnizimi me energji është njëri nga parakushtet për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe duke pasur parasysh se pritet dekomisionim i Kosovës A së shpejti, pastaj pas një periudhe edhe i Kosovës B, sa pritet që do të ketë zbrazëtirë në mungesën e energjisë, cilat vite do të jenë më të vështira, a ka far alternative për zëvendësim për plotësim të asaj zbrazëtire që po quhet "Gap". Cilat vite parashikoni se do të vijë ajo kohë?

Lidhur me energjinë e ripërtërishme kam dëshirë ta dijë se sa ka përparuar Kosova në plotësimin e kriterit për energji të ripërtërishme? Pastaj sa është realizuar projekti i Bankës Botërore me kredinë për eficiencën e energjisë?

Me pakon e tretë të ligjeve të energjisë të miratuara në Kuvend, dihet se do të liberalizohet tregu i energjisë. Ky liberalizim do t'i ketë edhe të mirat e veta porse në fillim do të ketë gogja do pasoja për një pjesë të sektorit të energjisë në rend të parë për KEK-un. A keni parashikuar se çfarë problemesh do të KEK-u për shkak të këtij liberalizimi?

Lidhur me Kodin telefonik është folur shumë e stërfolur, akoma nuk ka hap konkret në realizimin e kodit telefonik të Kosovës. A keni informacion se a është kjo afër apo jo?

Lidhur me autostradën energjetike e përmenden disa parafolës, autostradën energjetike me Republikën e Shqipërisë 400kË, u dhanë edhe komente se ku duhet të jetë faji. Është mirë që ju ta deklaroni këtu publikisht se cila është pengesa kryesore lidhur me këtë, përderisa kryeministri i Republikës së Shqipërisë e ka thënë publikisht këto ditë se ne kemi kryer pjesën tonë të punës. Ne e dimë se edhe Kosova atë pjesën fizike e ka kryer dhe cila është pengesa e mosrealizimit të kësaj autostrade energjetike. Pikërisht përshkak të acarimit artificial të raporteve me Republikën e Shqipërisë, mendoj që kjo çështje është mirë të thuhet publikisht edhe me zë të lartë.

Pas miratimit në Kuvend dhe përfundimit të të gjitha procedurave për ligjin për Trepçën, pasi që u bë i plotfuqishëm ky ligj çka mendoni të bëni më tutje me Trepçën, hapat konkret. Sa për sugjerim mendoj se po të gjinden mënyra se si të investohet vetëm në fushën e flotacionit dy tre milion euro, vetëm në ndonjë segment të flotacionit, përfitimet prej saj respektivisht ato para do të nxirren në një periudhë prej jo më shumë se dy tri vjetësh. Edhe me fjalë të tjera është një segment i cili ja vlen të mendohet të investohet.

Lidhur me amendamentimin e ligjit për miniera dhe minerale, nëse bëhet amendamentim respektivisht plotësim dhe ndryshim i ligjit mendoj që njëra prej pikave që duhet të ndryshohet

është edhe ajo në frymën e nenit 13 të ligjit për Trepçën lidhur me rentën minerare që t'i takojë komunitetit. Faleminderit!

DUDA BALJE: Kam 3 pyetje për t'i parashtruara, për Fshatin "Hade" që në është komunën e Obiliqit, këta banorët e fshatit Hade, siç jeni të njoftuar janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre, për ti lejuar KEK-ut shfrytëzimin e asaj sipërfaqe që sa kohë janë në pritje të shpronësimit të pronave të tyre nga KEK-, por deri tani këta banor kanë pasur shumë problem, që dy muaj nuk mund të e gjejnë fajtorin se ku mund ta zgjedhin problemin, këta njerëz e kanë shumë të vështirë, sepse askush nuk po ju jep përgjigje, lidhur me pronat e tyre se kur të behën pagesat për zhvendosje ku po qëndron problem? Për raportin vjetore të ndërmarrjeve publike për vitin 2015 pse nuk ka ardhur deri më tani për këtë vit? Ministria për Zhvillim Ekonomik e ka për detyrë të e monitoroi punën e bordeve të ndërmarrjeve publike a keni bërë ju si MZHE?

BESIM BEQAJ: Besoj që ministri na dha një informatë shumë të saktë të detajuar të punëve të ministres e cila nuk është fortë ministri falënderues por që kryen punë jashtë zakonisht të rëndësishme dhe duhet për ministrin një falënderim për punën dhe koncentrimin të cilin është duke bërë, sepse ka shumë punë e gjera të cilat nuk i ka në drejtpërdrejt në kompetencë të veten, pra këto kompetenca janë të shpërndara edhe sikur në shumicën e herëve të tjera krijohet përshtypja së përgjegjësia është në një vend, ndërsa të drejtat dhe kompetencat janë nëpër vend të ndryshme, pra në këtë kuptim dua pak jo ta ndihmojë ministrin po duke qenë edhe më herët themelues i kësaj ministrie, të sqaroi së bordet, nuk janë kompetence ministrit as që kanë qenë ndonjëherë e ministrit. Këto janë kompetenca e Qeveris edhe janë punë të cilat behën në nivel të zyrës së kryeministrit e jo të ministres është çështje ligji.

KRYETARI: Ndoshta nuk është kompetencë zgjedhja e bordeve, por monitorimi po.

BESIM BEQAJ: Monitorimi i performancës bëhet përmes Njesisë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, ndërsa unë kam pas shumë më intervenime fjalimin e secilit, por kështu më durim e kam dëgjo secilin veç e veç, sepse normalisht janë këndvështrime të natyrave të ndryshme dhe besojnë ta paraqesin si të tille gjendjen. Ajo çka është substanciale nga këndvështrimi i im është çështja Trepçës, kjo Qeveri dhe ministria më pompozitet në kanë sjell ligjin ne i kemi përkrah edhe punë nuk ka përfundou por tani ka fillu, realisht kemi hyre në një fazë tjetër tani më nuk ka arsytetime për atë çështjen që është në Gjykata Kushtetues dhe kjo është sqaru, tani ne presim që më implementim ka pas do ditë njëfarë euforie se ribemë Trepçën, thua së nuk ka qenë Trepça Kosovës më parë, pasurit natyrore janë të definuara më Kushtetutë dhe ligji ka dashtë më dhëne njëfarë rifreskimi të një bindje të tillë, po që ne e kemi aty në ligj dhe bashkimin e Trepçës, veprimet e harmonizimit të investimeve shpresojmë së Qeveria do ta merr përsipër, këtë çështje dhe do të ballafaqohet më pyetje në parlament rregullisht çka keni bërë më investime cila është pjesa veriore a keni shkuar ndonjëherë më vizitu apo skeni shku, të gjitha këto janë gjëra që kanë më ndodhur shpejt, pra besoj së tek ka fillu çështja e Trepçës si e tillë më u trajtou. Pikë tjetër është "Kosova e Re" po flas për gjerat strategjike, nuk do të flas për gjerat të cilat nuk janë operativ ditore, ju e dhatë një njoftim besoj që është shumë e rëndësishme. Do ta pyes ministrin a është ndalur kjo puna e Envidity-it dhe Sharrcemit? Më qëllim që mos kemi interferime të projektet, sepse deri në njëfarë masë kur e kemi pa rezerva me projektin Envidity, kur ministri i financave i ka sjellë më herët këto marrëveshje që ka rrezik prej interferimeve të

projekteve, sepse është theksuar se tek Envidity ka problem të energjisë. Unë besoj së nuk duhet më pas problem të energjisë, shpjegim ka qenë i mangët në atë drejtim, por që si të tilla na duhet më sqarua para qytetareve se cilat janë benifitet tek Envidity por edhe tek Sharrcepi. Sa i përket Intrekonsionit edhe këtu shpjegimi duhet të jetë i qartë pa ekuivokë, besoj shumë së Kosova e ka përfunduar punën e vet para Shqipërisë në kuptimin teknik por, projekti është vonuar për shkak të Shqipërisë dy vjet, për shkak të proceduarve të prokurimit atje që janë zgjatur, tani është proces politikë sepse kemi të bëjmë më linjë të komunikimit energjetike ndërkombëtarë edhe përfaqësimin energjitë ndërkombëtarë, që rrjedhin resurset energjetikë nëpër mekanizma të interkonsionit ndërkombëtarë në këtë drejtim besoj së kjo çështje duhet të adresohet në kuptimin politik.

U përmend këtu edhe dua ta ndihmoj ministrin, për hirë të informacionit sepse kam qenë pjesë e zhvillimeve, kur u përmend "AXOS-i" dhe kriteret për kualifikimeve shkëputja e kontratës, dua të bëjë më dije së asnjëherë nuk ka pas shkëputje të kontratës, sepse nuk ka pas kontratë. Kur flasim për këto gjera është mirë më sqaru deri në fund procesin, pse nuk ka pas kontratë, sepse më dokument të para kualifikimit, nëse më kujtohet në pikën një (1) është sqaru që Qeveria deri në momentin e nënshkrimit të kontratës ka të drejtë ta ndal procesin pa shpjegim për investitorin dhe këto dokumente të parakualifikimit i ka nënshkruar të gjithë që kanë konkuruar, pra kjo është element jashtëzakonisht i rëndësishme. Unë kam thanë edhe disa ditë në media e sugjeroi Qeverinë të jete më kujdeshme që mos ta humbin në procedura, përndryshe të gjithë investitorët e kanë nënshkrua këtë sepse ka qenë e tillë. Nuk do të hyj pse është ndal ai proces a janë plotësuar kriteret para kualifikimit, sepse aty janë dokumentet faktike, nuk behën më popullizem, por kjo është arsyeja kur flasim për AXOS-in dhe ndërprerjen e procedurave për nënshkrim të kontratës, por po ju lus të jeni të saktë kush do që flet, mos krijon akte apo veprim të cilat janë të pa qena.

GLAUK KONJUFCA: Këtë prej Qeverisë e kam dëgjuar.

BESIM BEQAJ: E dyta sa i përket KEDS-it, do të ju them së marrëveshja më KEDS-in më sindikata është marrëveshje publike, është konference e përbashkët e komitetit të privatizimit më sindikatën që ka qenë publike ku sindikata i ka pranua kushtet e procesit, sepse ka qenë në negociata në mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale, çka ka ndodhur aty sepse të gjitha kontratat sezonale që kanë qenë 1 deri 3 mujore janë shndërruar kontrata 3 vjeçare, pra kemi të bëjmë më kontratat sezonale të përkohshme të cilat janë shndërru në kontrata 3 vjeçare që KEDS ka marrë obligim të mos i largu punëtorët nga puna. Pra prej kontratës 1-3-6 dhe 12 mujore ju ka shndërruar në kontratë 36 mujore, ndërsa të gjitha kontratat afatgjatë që nënshkruhen i nënshtrohen Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, çka nënkupton kur kontrata i nënshtrohet Ligjit të Punës, nëse shkelet nga cila do palë, ajo mund të apelohe, pra të gjithë punësuarit, që konsiderojnë që ju ka shkel e drejta kontratës munden më shku më procedura ligjore dhe jo vetëm ata por secili punëtor në cilado ndërmarrje që të jetë dhe çfarëdo kontrate që ka i nënshtrohet Ligjit të Punës. Pra kontrata afatgjate i nënshtrohet Ligjit të Punës aty ku ka shkelje në mënyrë automatik hyjnë në procedura dhe vërtetohet, bile do të ishte padrejte për një shtet më ju thënë kompanive private së duhet më i mbajte pa qare punëtorët, por të krijohen kushte të barabarta për gjithë. Ligji i punës është pjesë bazike që duhet të respektohet, prandaj sa i përket edhe një çështje të ristrukturimit të një ndërmarrje publike, besoj që është mirë të punohet më shumë. Problem më

i madh i MZHE-së, janë ndërmarrjet publike. Unë e kuptoj, nuk ka problem më të madh se nuk ka kompetencë ndaj tyre, ka kompetenca e vetme është mbi monitorim, çka benë pas monitorimit jep një raport më rekomandime dhe nuk mund të merr asnjë veprim për asnjë vendim të ndërmarrjeve publike as komuniteti ndërministror, çfarëdo veprimi që të bëjnë vendimet i merr Qeveria. Unë besoj që ky ristrukturim, duhet të behët më kujdes, unë po frigohna se një shpërndarje e tillë mundet më qenë më probleme goxha serioze, sepse mundet më kriju njëfarë debalance të vogël të përgjegjësive të cilat kanë më hy ende në mekanizma më të keqijë, kur është bërë Ligji për Ndërmarrjet Publike besoj që atëherë është berë i mendomë mirë që politikat të janë të ndërtuara mirë sepse Qeveria shpreh aksionarin dhe është krijuar komiteti ndërministror i cili e mbikëqyrë edhe përçon qëndrimin e një qeverie e jo më ja lënë një ministrie. Pra këto kanë qenë idetë besoj, nëse e bën një draft të tillë do të japë kontributin maksimal gjithmonë që ta përforcojmë sa më mirë sepse mund më pas ide të cilat kanë më qenë shumë ma funksional dhe këtu e inkurajoj ministrin së do ta ketë mbështetjen e plotë tonën si komision, përndryshe mendoj edhe puna e ministrisë ti heqim këto punët operative dhe ditore, po në aspektin strategjik keni pas fokus shumë të përcaktum edhe tek energjia edhe tek teknologjia informative. Unë ju përgëzoi në futjen në buxhet të TIK-ut dhe të energjisë eficientë, besoj që janë veprime që kanë më tregu hala më shumë orientimin që keni ndaj zhvillimit ekonomik. Faleminderit.

FATMIR REXHEPI: Kërkoj falje për vonesën dhe nuk pata mundësi ta dëgjoj fjalën hyrëse të ministrit por i bashkëngjitëm këtyre mendimeve që i dhanë kolegët këtu.

Nuk ka dilemë që projektet dhe strategjia e projekteve të energjisë e ka një plan të jashtëzakonshëm për ekonomin e vendit dhe kjo po që u interesuan kolegët unë dua ti përsëriti dy tri gjëra. E para a do të kemi prodhim nga Kosova e Re në vitin 2021 ato 500 MegaËat që janë premtuar kjo është më e rëndësishmeje për neve, rritja e ekonomisë kërkon edhe energji sado që kemi treg të lirë mundë të blejmë por me gjithë atë mendoj se kosto e prodhimit në vend duhet të jetë më e lirë dhe për zhvillimin e ekonomisë. Pra e pata këtë dilema ministër edhe atëherë e pata thënë këtë se është vështirë të realizohet, kështu që do të jetë në pranverë ose më herët pra po e përsëris pyetjen përsëri se sa do të jetë vonesa apo kur do të jetë gati a do të ketë telashe tjera apo çfarë do të ndodhë? Përsëri pyetja e dytë është se është shtruar nga kolegët për mbikëqyrjen për realizimin të kontratave për gjithë ato ndërmarrje që ju kanë dhënë gjatë procesit të privatizimit këtë raste u përmend KEDS, edhe unë po i bashkëngjita këtyre për interesimin dhe opinionet që kanë dalur se sa i rrinë gati Qeveria dhe i përdor mekanizmat e vetë mbikëqyrës në përmbushjen e kriteve të kontratës sipas dinamikën pa toleruar dhe pa i jep shumë hapësire në mënyrë që ajo të jep efektet e veta në mënyrë që investimet po mendoj se ka dilema të mëdha se a po kryhen investimet sipas kontratës në kohën e duhur. Unë nuk e kam informatën, besoj se duam të dimë pasi është në interes të jashtëzakonshëm. Pjesë tjetër është se sa na lejon neve ligji në kuadër të tregut të lirë se një operator nuk i përmbush këto kontrata detyrime shohim se cila është zgjedhja alternative e zgjedhjes së këtyre problemeve, pasi që aq shumë kritika kanë filluar të mbledhë për KEDS-in, në një kohë tjetër ajo nuk bëhet brenda nate. Paraprakisht duhet të jemi gati ta shoh edhe ai konkurrencën në tregun e lirë, pra kur është mundësia dhe si është mundësia të shohim një operator tjetër që është konkurrent në këtë tregun e energjisë dhe ofron shërbime sa e lejon ligji dhe si. Mendoj se këto dy projekte që janë ofruar për synimet që i kanë qëllimet që i kanë parapërgatitjet që i kanë nuk është çudi, ato kanë interesin e vetë të jashtëzakonshëm ne nuk duhet

të bëjmë në grackën e tyre dhe çfarëdo që shkruajnë ata në letër do të ndodh nesër është në interes për neve. Unë kam lexuar shumë në këtë sektor dhe nuk po mundem ta kuptoj se si në një vende kaq të vogël me këtë dendësi me këtë relief me këtë ujë me këtë tokë me këtë thëngjill që e ka e të mos gjejë vend tjetër për këso projekte kësaj natyre munden të vendosen në Zelandën e Re, në Kanada, në Afrikë të Jugut apo të Veriut, ku nuk ka njerëz ku futen bomba atomike dhe nuk gjenë asgjë po në Kosovë në mes të Dukagjinit me shkëput token 300- 400 metra me bërë atë presion në atë temperaturë, vetëm kur e shiheni Deçanin ka shkuar në Prizren....grupit të LDK-së. faleminderit që e ka përkrahë dhe mendoj qeveria duhet të largohet nga ky projekt nuk ka as interes ekonomik as interes publik...

(Polemikë)

KRYETARI: Ajo që mendoj se u cek dhe një çështje ju lutem ministër ta komentoni, ne kemi raporte tregtare me Serbinë, biseduam kështu që atë pjesë kaloni por tregtia, kodi, KOSSTI, shumë çështje tjera po përfshihen në raportet tona ekonomike me Serbinë. Nëse Serbia na ndalon kodin, interkonksionin, dëmet janë me dhjetëra miliarda. Bllokimi i interkonksionit ka ndikim shumë të madh në furnizimin e energjisë, mendoj se bisedat mund të zgjasin me dekada për shumë çështje të mos pajtohemi. A keni menduar, ministria, qeveria se si ti përgjigjemi Serbisë në këto raste? Mendoj se ne duhet të ndërtojmë një strategji patjetër të mos presim a do të pranoj Serbia apo jo, ne duhet të përgatitemi ti mbrojmë interesat tona si shtet me këto intervenime, nuk po them sot të më përgjigjes, mirëpo duhet të mendojmë në këtu edhe në Kuvend edhe në qeveri. Ata janë të toleruar se do të mbërrijnë marrëveshjen dhe e ri negociojnë 10 herë marrëveshjen, mendoj se duhet të reagojmë për disa çështje që janë shumë esenciale, që janë për interesat tona ekonomike. Mendoj se do të flasësh për mbikëqyrjen për kontratave dhe mendoj se duhet të përfshihet në raportin për ndërmarrje publike, ZRRE. Ministër e keni fjalën.

BLERAND STAVILECI: Ministër i Zhvillimit Ekonomik, unë po mundohem me shkuar me rend dhe mandej ato që janë përsëritur disa herë nuk do të kthehem, Kosova e Re, po i marr dy qëndrime me shumë politike që besoj që tregojnë shumë edhe orientimin tonë dhe domosdoshmërinë për t'i shkuar këtyre proceseve deri në fund, mendoj atë që e thotë Presidenti Obama duhet të jetë udhërrëfyes i të gjithëve i të gjitha shteteve dhe besoj që një gjë e tillë behet dhe e bëjmë edhe në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, sidomos pas ngjarjeve që kanë ndodhur një herë në Japoni pastaj në Ukrainë, që shteti i cili nuk i kontrollon burimet e veta energjetike nuk mund ta kontrolloj as të ardhmen e vet, tjetra meqë ne po e bëjmë besoj në mënyrën me të mirë të mundshme projektin Kosova e Re dhe nuk është aspak e lehtë, po të ishte e lehtë si ky po ashtu edhe Trepça do të kryhej shumë me herët, kemi me shumë se 12 vite që është nisur dhe unë ju kam treguar me herët, ju tregoj tash, ju tregoj edhe ndoshta kur të kemi ndonjë sesion të veçantë vetëm për atë projekt që unë e kam gjetur projektin me kontribut të Qeverisë 200 milion, me ngritje të çmimeve 90% dhe me efikasitet 37% dhe me strukturë "BOO", çka kemi sot, Qeveria nuk jep 200 milion euro, rritja e çmimeve është 28% për 6 vite, nëse e ndan përpjesëtimisht në vite është 4.66 për vit, kemi efikasitet 40% dhe e kemi strukturën "BOT" mbas 20 viteve transferohet në pronësi të Qeverisë, vetëm këto 4 pika të negociohen dhe të vihet në këtë moment tash ne nuk kemi mundësi çdo ditë të bëjmë ngjarje dhe nuk dua ti medializoj këto sikurse edhe çështjen e Trepçës sepse kemi pasur mundësi në aspektin politik të tregojmë shumë çka, po me vjen keq për fuqinë politike se besoj gjëra me të mira se sa këto nuk e dëshmojnë se pari fuqinë intelektuale pastaj edhe të tjera, që është më e rëndësishme se sa ajo politike, nëse

doni me tepër mund te flas me shumë por po e le më mire kur te jetë e gatshme të gjitha këto janë te strategjia, janë tre skenar si: Skenari i Importit, Skenari i Sigurisë së furnizimit dhe Skenari i Eksportit. Kosova e Re, Kosova B dhe Kosova A ku po kryhet studimi për nevojën e investimeve dhe ne këtë e kemi edhe ne strategji sepse i kemi tre skenar dhe njeri është ai qe po e përmendi por janë edhe dy të tjerë se a do të operoj me orë të kufizuara apo pa orë të kufizuara sepse kemi edhe obligime ndërkombëtare sidomos këtë qe janë me Traktatin e Komunitetit, është e ashtuquajtura për “LCP” edhe “ID” pra për emetimet industriale janë dy direktiva qe ne duhet ti zbatojmë dhe do të shohim se me cilën prej varianteve do të shkojmë. Skenari jonë është ai i Sigurisë së Furnizimit, pra të lirohemi prej importit dhe këtë po e bëjmë me një përmbyllje sikurse ajo e Obames qe është shumë politike qe armiqtë e ndërtimit unë i konsideroj shumë afër afër armiqve te pavarësisë së Kosovës, pa pavarësi energjetike mos mendoni se kemi pavarësi, shikojeni edhe procesin e Berlinit pse ka nisur, infrastruktura - rrugët lidhesh dhe nuk ka mundësi se si të mos lidhen dy shtete fqinje por shikojeni energjinë te traktati i komunitetit nuk janë vetëm 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, e keni edhe Ukrainën e keni edhe Moldavinë, Gjeorgjinë, Azerbajxhanin dhe shtetet e tjera dhe këtu po e lidhi me një përgjigje në ne një pyetje qe u be, edhe te strategjia e kemi objektiven e katërt, zhvillimi i infrastrukturës për gazin natyrorë qe është TAP-i dhe ne kemi aplikuar bashkë me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë se Shqipërisë për studimin e fizibilitetit ne vlerë prej 300.000 euro për të qenë pjese edhe ne në linjën e gazit, pra “TAP” po e dimë qe e ka edhe një dege qe është Union Adriatik qe shkon pastaj kah Mali i Zi dhe Kroacia nëpërmjet Shqipërisë, tek pyetja e deputetes Shala mendoj qe edhe këtu sikurse edhe tek rastet tjera pasi qe ju e keni bere monitorimin e zbatimit te Ligjit për Miniera dhe Minerale edhe ne jemi të hapur qe të shohim mundësinë pas raportit te ulemi përsëri ndoshta te jete një tematikë e veçante për këtë dhe të shohim se cila është rruga me e mirë pra nëse ka nevojë ta bëjmë një ligj te ri, sa i takon ndërmarrjeve publike unë edhe vet e thash se do të jetë koncepti i ri, besoj edhe këtu do ta diskutojmë, mënoj edhe këtu ka nevojë për një harmonizim qëllimesh asnjëherë nuk pretendojmë se truri është tek Qeveria, mendoj se është dëshmuar shumë here edhe në këtë Komision Parlamentar por edhe ne grupe te tjera shumë deputet te cilët kanë kontribuar ne zgjidhje shumë me të mira, por edhe këtu nuk është se nuk janë bërë dy veprime qe përsëri e tregojnë atë qe e thashë me herët dhe besoj qe edhe deputeti është mirë ta shoh se si është bërë përzgjedhja e Drejtorit Menaxhues të “KRU Prishtina” dhe aty e keni përgjigjen ne shumë pyetje tjera apo edhe zbatimin e marrëveshjes me Ambasadën Britanike për përzgjedhjen e këtyre bordeve po fatkeqësisht këtu nuk mendoj se problemi është tek njerëzit apo tek ministrat individualisht, mentaliteti është tek te gjitha partitë politike pa përjashtim, e kemi pa edhe neper komuna se si behën nuk e di a keni informata apo jo por është i njëjti model dhe ne duhet ta ndryshojmë modelin me fuqi intelektuale përsëri dhe jo me fuqi politike. Autostrada energjetike po e them këtu sepse e di qe janë thënë shumë gjera dhe e di qe beri shumë buje debati i Kryeministrit te Shqipërisë me disa prej gazetarëve tonë por edhe aty nuk u dha përgjigja e sakte por realiteti është ky, ne aspektin fizik punimet kanë përfunduar ne aspektin e vënies ne funksion ne kemi KOSTI-n nga marrëveshjet e Brukselit. KOSTI duhet të jete anëtar me të drejta te plota i të ashtuquajturit rrjet evropian te operatoreve të sistemit të transmisionit “MSI” dhe ne tash i kemi dy momente, njeri tash ne prag te asamblesë te këtij trupi MSI-së qe mbahet ne javën e dytë të nëntorit dhe i dyti është ai që ju referua Glauku, ne kemi marr Presidencën dhe këtu kemi berë një lobim te hatashëm diplomatik dhe kemi arritur qe çështjen e Serbisë ta ngrisim ne nivel te ministrave ne takimin qe patëm me 14 tetor ne Sarajevë dhe kemi vene afate kohore sepse Serbisë do t’i ngritet rasti dhe pastaj ky rast do të shkoj deri te arbitrazhi dhe Kosova te kërkoj te gjitha demet ekonomike dhe financiare qe janë shkaktuar ne te kaluarën dhe te ju them këtu dhe do te

habiteni qe edhe shtetet si Ukraina, Moldavia, Gjeorgjia kanë votuar për kërkesën tonë, vetëm Mali i Zi ka abstenuar dhe kanë pasur një arsye objektive sepse ne keni biseduar por nuk e kanë pasur Qeverinë e zgjedhur ato ditë, qëndrimi i tyre ka qenë që të abstenojnë dhe pastaj është zgjedhur Qeveria. Ky është realiteti dhe ka një angazhim shumë të madh të të gjithë partnereve të institucioneve ndërkombëtare financiare që kanë mundësuar ndërtimin saj duke u nisur nga Banka Zhvillimore Gjermane e me këtë rast e kemi edhe Kancelarën Merkel e cila ka biseduar me Kryeministrin. Staf i saj ka kërkuar informacione edhe prej neve dhe mendoj që edhe vet kjo që e kemi futur në agjendën e Sarajevës, po i them, me votat e shteteve që ndoshta me shumë do të prisnim që do të votojnë për kërkesën tonë, besoj që ka qenë një fitore diplomatike por që nuk kemi dashur të bëjmë zhurmë në media pa përfunduar deri në fund sepse tek e fundit neve na intereson që ajo të hyjë në funksion.

Sa i takon incidentit në KEK edhe kjo është çështje edhe KEDS-i, edhe Aeroporti, edhe ato që u lidhin me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ndoshta me të lehtë e kam ta jep përgjigjen që nuk e kam në përgjegjësi të drejtpërdrejt por këtë nuk e them asnjëherë edhe nëse është 1% përgjegjësia ime, unë mundohem ta ngris në 100% dhe mendoj që kjo çështje sikurse edhe ato të tjerat në i kemi organet se ku ti adresojmë ato dhe duhet të ketë pak me shumë informata, atë që e them edhe me herët sepse Glauku e përmendi shkëputja e kontratës, mendoj që deputeti Besimi e përmendi shumë mirë, që një gjë e tillë nuk ka ndodhë e para, e dyta ka një komitet të post privatizimit dhe e treta mos harroni se ZRRE-në këtu e keni dhe ajo është përgjegjëse për monitorimin e implementimit të marrëveshjeve të tilla. Por edhe këtë po e them nëse ju mendoni në vijmë bashkërisht me ta për të gjitha këto, ne kemi pasur edhe problemet që i ngrisin bizneset edhe njerëzit, ne i kemi edhe KEK-un edhe KEDS-in edhe KOST-in edhe ZRRE-në, pra edhe ministria bashkë me to sa do që i kemi ato probleme që nuk i kemi kompetenca të drejtpërdrejta por nuk përtojmë që ti marrim këto përgjegjësi dhe një pyetje që nuk u ngrit e që po e them siç e harrova për gazin, e njëjta ka qenë edhe për Feronikelin, është bërë temë por e kemi mbyllur dhe kemi negociuar me secilin veç e veç dhe pa pasur përgjegjësi të drejtpërdrejtë i kam ftuar të gjitha palët dhe shihni se si sot që puna ka rinisur dhe e njëjta vlen edhe për Ministrinë e Mjedisit, sepse deputetja Duda Balje shkoj dhe duhet ditur kush e ka shkaktuar problemin e 2004-ës, cilat kanë qenë pasojat dhe cilat kanë qenë problemet por dhe mësimet e nxjerra prej atëherë. Në vitin 2011 Qeveria ka aprovuar një Kornizë të Politikave të Zhvendosjes, pra që mos shkohet me shpronësim dhe unë prapë edhe pse nuk e kam përgjegjësi të drejtpërdrejtë, në 6 takime me komunitetin e Obiliqit në fshatin Shipitullë me familjet Mjekiqi, Berbatovci, Krasniqi dhe Mirena. Vetëm në njërin prej tyre nuk kam qenë, kemi ndenjur me orë të tëra për të dialoguar me ta dhe dje e kemi vendimin në Qeveri që kemi vendosur për datën e prerjes dhe nisjes së incizimit dhe si behet kjo, duhet lexuar sepse ekzistojnë ato dokumente se përgjegjësi e kujt është kjo, me se lehti është të thuhet para mediave është përgjegjësi e jotja pastaj mediat shkojnë dhe nuk e lexojnë, vetëm merreni dokumentin e kornizës së politikave të zhvendosjes KEK-u e angazhon kompaninë, kompania e përgatit planin, Ministria e Mjedisit e aprovon dhe pse kemi hy në për të qenë pjesë e vendimmarrjes, për t'i ndihmuar institucionet tjera, për të marrë përgjegjësi të përbashkëta dhe për të ditur që projektet e ardhshme në infrastrukturën energjetike janë të lidhura me obligimet mjedisore dhe sociale. Dhe me këtë strategji që do t'iu vije javën tjetër do ta shihni që ne shumë shpejt dhe në këtë periudhë 6 mujore do ta kemi fokusin e plotë të çështjes sociale dhe ambientale dhe jo ta marrim epitetin ose atributin e atij që qan për të kaluarën se pse nuk kanë ndodhur këto gjëra por me atributin e atij që don ti zgjedh këto gjëra një herë e përgjithmonë dhe kush do që të jetë në Qeveri mos të ia lejmë këto

probleme e as gjeneratave të ardhshme dhe as atyre familjareve ne Obiliq dhe pse e kemi këtë përkrahje të Bankës Botërore e qe nuk ka ekzistuar deri me sot, sepse i kemi marrë tri zotime, qe do te ketë strategji te mirëfilltë te ndikimit ambiental dhe sociale një për mihjen e re qe do ta bej KEK-u me studimin e fizibilitetit si pjesë e një komponentë te saj dhe tjetra për Termocentralin dhe kjo qe lidhe me zhvendosjen pra tri zotime qe ne i kemi marrë qe do te duhej ndoshta dikush tjetër qe t'i merrte por ne po bëjmë një zgjidhje dhe me se lehti e kam qe te them kjo nuk është bërë ne vitin 2009, kjo nuk është bërë ne vitin 2004. Ju keni qene ne Qeveri ata nuk kanë qenë ne Qeveri, unë me këto gjera nuk merrem, shoh prej tash tutje se si t'i zgjedhim problemet dhe besoj qe përgjigjet me të mira se ka nisur diçka e mbarë e kemi Trepçën dhe Kosovën e Re gjithmonë ne pajtim me ato qe i thatë të gjithë prej juve edhe Besimi, edhe Kryetari Muhameti, qe puna e vërtet nis tash, problemet e vërteta nisin tash, sfidat po aq sa edhe mundësitë edhe rreziqet nisin tash sepse ne një farë forme Trepça sikurse edhe plot ndërmarrje të tjera kanë qene ne një lloj lëvizhje te një stauskohe qe po punojmë, s'kemi probleme dhe nuk po mendojmë si me tutje, kemi problem sepse jemi ne AKP por asnjëherë s'kemi menduar se kur ti ekspozohemi sepse zhvillimi dhe tendenca për tu zhvilluar gjithmonë e bartë me vete edhe rrezikun sepse nëse hapet dhe nisin investimet dhe kemi operator të ndryshëm ne të ardhmen ndoshta edhe investitor nuk është e thjeshte ndoshta siç ka qene deri me sot por jemi mësuar te jemi kështu te ankohe mi për problemin dhe te mos gjejmë zgjidhje adekuate. Dhe mendoj dhe pajtohem me ate qëndrimin e juaj qe ashtu siç e bëmë te grupi punues për hartimin e Ligjit te ketë një trup koordinues dhe përgjigja ne atë se çka tutje ne e kemi agjencinë e privatizimit e cila do ta kryej studimin e fizibilitetit deri ne muajin shkurt, dhe e keni parë qe ne Ligj kemi thënë se jo me vonë se 6 muaj prej përfundimit të fizibilitetit do të përgatitet strategjia, pra edhe me këtë po dihet pak edhe ne aspektin kohor se cilat janë afatet.

Sa i takon Endivity dhe Sharrcemit, përsëri përgjigjen e gjeni tek strategjia e energjisë, ne për të dy sektorët kryesor por edhe për sektorin minerar thash i kemi tri strategji qe mendoj qe janë shumë të mira e kemi marr edhe përkrahjen e të gjithë partnereve, strategjia e energjisë ju tregoj kemi pritur një muaj për tu konsultuar me te gjitha palët, Komisioni Evropian dhe Banka Botërore kanë kërkuar zgjatje edhe për dy jave, kemi thënë po e zgjasim edhe dy jave edhe kemi marr zotime te reja dhe këtu nuk trajtohet ajo tash edhe këtë duhet ditur qe komisioni për PPP-në është tek Ministria e Financave. Kërkesa ka ardhur ne vitin 2013 ka qenë një kontekst tjetër, departamenti i PPP-së natyrisht qe ne cilësinë e sekretariatit për Komitetin e Ministrave është dashur ta jep një përgjigje, ne aspektin teknik dhe procedural e ka dhënë por unë mendoj qe si kjo ashtu edhe te Trepça qe e kemi specifiku me disa ligje, nuk janë vendime dhe as nuk do te duhej të ishin te tilla qe te kalojnë pa miratimin e deputeteve dhe jemi te gjithë ne bashkërisht ata qe do ta japin vendimin përfundimtar. Por pajtohem me ato diskutimet qe u ben që në të njëjtën kohe te ketë shumë projekte që edhe nëse bien ndesh edhe nëse nuk bien ndesh po supozojmë qe nuk do te bien ndesh tash, unë nuk po hyjë ne ato mundemi ndonjëherë tjetër te diskutojmë por ne kemi për shembull aspektin mjedisor. Dhe ne edhe tek strategjia jemi mundu ta balancojmë atë qe e kam thënë edhe ne raport me shoqërinë civile nuk është se ne po marrim një drejtim qe ne po ndërtojmë vetëm me thëngjillin dhe ne e kemi edhe ne strategji po thuajse gjysmën prej njerit burim dhe gjysmën prej tjetrit dhe i hapim rrugë asaj qe janë burime te diversifikuara në të ardhëm pra në këtë rast gazit, për sa i takon ngritjes së çmimit e fola dhe po e them përsëri po shfrytëzoj diçka qe tha dje një njohës i sektorit të energjisë qe ne vitet e 80-ta një ish drejtor i KEK-ut kur kanë pasur një problem me Maqedoninë në atë kohë kur kanë furnizuar tha se ekipi i eksperteve ka ardhur menjëherë të nesërmen dhe i ka pyet sa kushton ata i kanë treguar një çmim dhe ata i

kanë thënë se s'ka çmim me të shtrenjte se sa ai për energjinë që nuk e ke dhe kjo është besoj pastaj politike. Por ka shumë mundësi që ne ta shpjegojmë, nëse dikush thotë burimet alternative e që duhet të ketë por nëse e marrim vetëm si një burim sot e mërrni tarifën tek ZRRE-ja njëjtë nëse i merreni për katër burimet hidro, erë, ujë dhe biomasë dhe e merreni një mesatare komulative e keni 109 euro për megavat, në kontratat që do të kemi me investitorin amerikan e kemi precizuar pak a shumë si ajo marrëveshja e asaj që deri në ditën e fundit mund të tërhiqesh nga mosnënshtrimi pa asnjë arsytim që nëse kalon pragun prej 80 pra ne tërhiqemi, pra edhe aty kemi bërë një lloje sanksionimi.

Për sa i takon liberalizimit të tregut ndoshta nuk e keni informatën prapë është e ZRRE-së dhe mendoj se ndoshta mund të keni një lloj takimi ku mund ti flisni këto gjera, por unë po e marr prapë të drejtën që me e thënë para jush që ne e kemi edhe pjesë të prioriteteve gjatë presidencës liberalizimin dhe ai ka nisur sepse ZRRE-ja i ka dhënë një licencë HEPI-it kroat. Në njërin nga mbledhjet e kaluara është fjala për liberalizim në furnizim dhe unë mendoj që edhe veprimet e ardhshme që do të behën janë në këtë drejtim e keni edhe të strategjia objektivi i dytë pas atij të sigurisë se furnizimit është integrimi në tregun rajonal të energjisë, marrëveshjen me Shqipërinë i kemi të gjitha në si dy Qeveri dhe në si dy Ministri e jona dhe e tyre, mes KOST-it dhe OSP-së, interkoneksioni dhe po shkojmë edhe një hap me tutje në bashkë themelimin e bursës së energjisë dhe edhe këtu e kemi modelin Skandinav e dini Nortpulin. Skandinavia ka qenë, Norvegjia ajo që e ka nisur dhe sot e kemi një bashkëshpërndarje të katër shteteve skandinave nga 25% Danimarka, Finlanda, Suedia dhe Norvegjia. Për sa i takon KEDS-it, unë kam pasur disa takime dhe do të vazhdoj ti kem, dhe edhe këtu pavarësisht asaj unë e kam të lehtë ta them monitorimi i implementimit tek ZRRE-ja dhe shkoni ju e kemi taku sindikatën dhe e kemi lenë që javën tjetër të takohemi me të gjitha palët pikërisht dhe diskutimi ynë do të jete mbi bazën e asaj që e tha deputeti Besim por edhe në edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, edhe ZRRE-ja do të jetë e ftuar bashkë me KEDS-in do të shohim se cilat janë modalitetet aty nuk folët për shkelje.

(Polemikë)

Po besoj që mandej është mirë që edhe ky problem por edhe tjerat kur të zgjidhen me dal me një deklaratë edhe me thanë nganjëherë edhe mbështesim diçka të mirë e jo me thanë vetëm keq, keq, keq, se nuk është gjithçka keq po ky është mentaliteti i juaj dhe e respektoj.

GLAUK KONJUFCA: Nëse shohim diçka të mirë nuk pritojmë.

BLERAND STAVILECI: Jo me të mirë se sa Ligji për Trepçën nuk ka po çka me be.

(Polemikë)

KRYETARI: Ministër asnjë deputet nuk e keni ndërpre kërkoj nga deputet të mos ju nderprejnë.

BLERAND STAVILECI: Jo nuk ka problem, vazhdojmë për operatorët ilegal për deputetin Berisha këtu besoj jo vetëm të telekomunikacioni por edhe tek energjia zgjidhen atëherë kur të implementohen marrëveshjet sepse marrëveshjet e Brukselit. Po flas për të dyja energjia dhe telekomunikacioni sepse lidhet edhe me kodin pyetjen që ma parashtrij deputeti Raif, që ne pra jemi marr vesh që kodi edhe zhbërja e këtyre operatorëve ilegal është në kuadër të planit të

implementimit të kësaj marrëveshje dhe në anën tjetër është dashtë që një operator, prapë po e them që edhe kjo në media është devijuar, jo licencë por autorizim i përkohshëm deri sa të gjithë numrat të shtegtojnë në prefiks të +383. Dhe edhe aty ka pasur probleme të tilla dhe në jemi marr vesh është pjesë e marrëveshjes që një herë e përgjithmonë të zhbëhen. Është e vërtetë që ka pasur dëm të konsiderueshme financiare edhe tek telefonia, edhe tek energjia, a bile tek telefonia ju e dinin të kjo me Monako telekomini se sa miliona kemi paguar, dhe tash imagjinoni momentin që në e kemi kodin tonë 20 milion do të mund të orientohen diku tjetër dhe jo për të paguar licencë të tillë.

Për burimet e ripërtrishme dhe për projektin me Bakën Botërore të efikasitetit të thashë "One Stop Shop-in" në kemi në kuadër të agjendës 20-20-20 që 25% e prodhimit të gjithmbarshëm të energjisë duhet të vij nga burimet e ripërtrishme. Në i kemi 4 çaqe pra energjia ujore 240 megavat, energjia e erës 150 megavat, diellorja 10, dhe biomasa 14 megavat, të ju them të drejtën në do ta bëjmë "One Stop Shop-in", mirëpo nuk jemi të kënaqur edhe këtu raportin e presim nga ZRRE-ja, sepse ZRRE-ja i lëshon autorizimet preliminare dhe finale që të shohim raportin, autorizime, obligime dhe investime sepse nuk është e kënaqshme gjendja të cilën e kemi sot. Ka investitor të cilët i kanë zbatuar por ka edhe të tillë që kanë mbetur peng i problemeve financiare por në këtë jemi duke e trajtuar në mënyrë që më të mos kemi probleme të tilla ose tek e fundit të gjendet mënyra që ata që nuk janë të gatshëm brenda një periudhe shumë me të shkurtë kohore, sepse me rregullore të ZRRE-së ju lihet 4 vite që të mos investojnë ta shkurtojmë bile deri në një vit, ai që nuk mund t'i siguroj për një vit financat dyshoj që mund t'i siguroj pas vitit të tretë ose vitit të katërt. Besoj që nuk i mbeta dikujt pa u përgjigjur.

KRYETARI: Faleminderit ministër, faleminderit në përgjigje edhe në raportim, urdhëroni deputeti Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit ministër për sqarimet por në fushëveprimin tuaj hyjnë bukur shumë çështje të rëndësishme të funksionimit për ndërmarrjeve publike e deri tek mbikëqyrja dhe monitorimi i punës e ku ta di. Faleminderit për sqarimet e ofruara por me gjithë respektin tuaj edhe ndaj angazhimit, prapë dyshoj që krejt në kazanin intelektual që po doni me paraqit dhe duke e përgatit për zhvillimin e ministrisë ta gjuan dikush një guri prej politikës edhe ta nxjerr jashtë krejt atë far qorbe edhe sinqerisht...

BLERAND STAVILECI: Po kur e gjuajtën, pse s'u prish deri tash...

(Polemikë)

ENVER HOTI: Të respektoj si ministër me perspektiv e krejt ato, ti po e jep kontributin tënd por pasojat prej politikës janë të vlefshme për këtë vend.

BLERAND STAVILECI: Edhe një përgjigje është shumë e rëndësishme por e harrova dhe po kërkoj ndjesë sepse në dje e patëm takimin me komunitetin drejtues për projektin e fizibilitetit për Kosovën B, dhe tash të një pjesë e mozaikut të energjisë që është ky burimi tradicional në kemi rehabilitim e Kosovës B dhe e kemi Kosovën e Re. Kosova B përfundon studimin e fizibilitetit në muajin maj të 2017-ës, dhe unë kam kërkuar edhe dje që të bëhet sinkronizimi i rehabilitimit dhe i ndërtimit në mënyrë që të mos ketë ndërprerje të tillë, normalisht që e fundit

qe mbetet është importi, është edhe ky studimi pra për nevojën e investimeve për operimin e Kosovës A deri sa të futet ne jetë Kosova e Re dhe po mendoj qe nuk ka alternativ përveç kësaj siç duket.

KRYETARI: Mbetet për tu parë sidomos ndoshta duhet me insistuar për mu kryer ky studim fizibiliteti atje ne KEK qe kanë filluar. Bile ta kem parasysh kur te diskutojmë sepse ata kanë premtuar qe dikur ne shtator te jetë gati ai studim. Mirë mendoj që mund të përfundojmë, ka qenë një diskutim shumë i mirë me lejoni qe pak të shoh këtë Endvidity, sepse pak a shumë ky është një projekt serioz por nuk është mirë ta trajtojmë në mënyre popullisite askush, për arsye se ne e kemi 14 miliardë tonelata thëngjill te cilat ndoshta te eksploatueshme nuk janë me shumë se 10, sepse janë vendbanimet dhe ka probleme me eksploatuar. Kosova ka këtë resursin kryesor dhe duhet ta bëjmë strategjinë se si do ta shfrytëzojmë, a do ta shfrytëzojmë mi djeg me ja qit timin e ndotja është shumë ma e madhe.

GLAUK KONJUFCA: Unë jam i gatshëm me ja qit timin...

KRYETARI: Po për ty e dimë, vetëm të shohim se janë çështje serioze këto edhe ne këtë Komision i kemi. Ministër faktikisht është te ai komiteti atje qe ti e the dhe nuk e ke ti në ne kompetencë, mirëpo ne do të kërkojmë qe ne strategjinë e energjisë ne me dit strategjinë afatgjate te menaxhimit të burimeve te linjtit, a ka Kosova llogari me shkuar me shumë megavat e mi djeg apo duhet të shkojnë ne kimizim dhe ne këtë teknologjinë qe pjesërisht është me këto dy projekte apo duhet me shti turrshi edhe me than s'ka as njëra dhe as tjetra po e lajm s'po e shfrytëzojmë thëngjillin dhe po rime ne vend. Për ta marr këtë vendim nuk mundemi ne me marr me hamendje edhe këtu duhet me pas studime, duhet me berë eksplorimin, duhet me berë hulumtime multidiciplinare te mundësive të shfrytëzimit te thëngjillit ne ketë drejtim kjo kishte me qenë ma korrekte sa i përket kësaj ne si komision kemi pru qëndrime shumë rigoroze për zbatimin e atij projekti, Qeveria mirë ka berë qe e ka tërheç propozimin, ne tash duhet te shohim se çka duhet te bëjmë me të edhe duhet të shohim dimensionet e tij, hulumtimet duhet me i pas.

FATMIR REXHEPI: ...kuk e marrim na përgjegjësinë.

KRYETARI: Përgjegjësinë duhet me marr kjo shoqëri, se nuk mund ti dëgjojmë tregimet e mia dhe tuat këtu por duhet me fol ne bazë të studimeve qe janë...me fal të lutem mos me ndërhyje, po dua me thanë as çka thua ti e as çka them unë, por duhet me u be studimi se çka me bërë me gjithë këtë thëngjill.

FATMIR REXHEPI: Ngo çka të them unë...

KRYETARI: Çka?

FATMIR REXHEPI: Kur ta qoj gishtin unë ki me ngu.

KRYETARI: Po ti e qon gishtin por shumë te tjerë nuk e qojnë kështu që gishti yt e ka një fuqi të konsiderueshme por jo të padiskutueshme.

GLAUK KONJUFCA: Merre me mend Fatmiri mu bë shumicë...

KRYETARI: Ishalla bahet shumicë Fatmiri nuk kam kurrëgjë kundër, vetëm se duhet se edhe Fatmiri mi qu gishtin jo me hamendje por mi qu gishtin ne bazë të studimeve, unë po lyp me votuar me marr vendim të përgjegjshëm afatgjatë se sot nuk janë budalla që ne krejt boten është ne fazën e eksplorimit, ne fazën e projekteve pilot. Unë pajtohem me ato që është me e ndjeshme në Kosovë sepse është dendësia e popullsisë rreziku i ujërave nëntokësorë, por krejt këto duhet mi eksploruar, nuk mund ta mbyllim derën ne, çdo investitor që vjen na me i thënë jo s'bën, ne duhet me marr vendime ne mënyre te informuar edhe krejt çka ka kërkuar ky Komision është studimi i fizibilitetit.

(Ndërhyrje)

Secilit projekt te rëndësishëm ne Kosovë deri me sot ne i kemimirë është kur kërkojmë kushte unë pajtohem me ty, por duhet të kërkojmë studimin e fizibilitetit te argumentuar, atë po kërkojmë na këtu edhe kemi bërë shumë vërejtje për atë që ka ardh edhe pse edhe na atë që ka ardhur prej ministrisë janë shumë sene krejt rreziqet janë aty, nuk është se i kanë fsheh këto rreziqe, krejt rreziqet i kanë cek aty por është mirë me i lexuar mirë na, krejt rreziqet i kanë cek aty, edhe ujërat nëntokësorë dhe te gjitha janë cek.

FATMIR REXHEPI: Nuk i lexon kërkush ato po leje.

KRYETARI: E po, problemi është se nuk po lexon kërkush në këtë shoqëri o Fatmir, aty është problemi se s'jemi tu lexuar.

GLAUK KONJUFCA: Mas pari qeveria s'po lexon.

KRYETARI: Unë kërkoj nga Qeveria dhe ne Komision edhe ne do ta trajtojmë, ne duhet me bërë strategji, a duhet ta shfrytëzojmë këtë thëngjill, qysh po e shfrytëzojmë ose po vendosim mos me shfrytëzuar hiç, gjeneratat e ardhshme behën me te mençura edhe e shfrytëzojnë, e këto janë tri alternativa, nuk keni ne këtu shumë sene.

(Ndërhyrje)

Duhet me pas studimin o Fatmir, e jo me fol përmendesh. Vazhdojmë me nxjerrjen e konkludimeve. Mendoj që mund të përfundojmë që ka qenë një diskutim shumë i mirë. Më lejoni që pak të shoh këtë Envidity, sepse pak a shumë ky është një projekt serioz, nuk është mirë me e trajtuar në mënyrë populiste askush, për arsye se ne i kemi 14 miliard tona thëngjill, prej të cilave të eksploatueshëm nuk janë më shumë se 10 miliard tona. Kosova e ka këtë resursin kryesor edhe duhet me bërë strategjinë si do ta shfrytëzojë, a do ta shfrytëzojë me djeg në ajër, e ndotja është shumë më e madhe, vetëm të shohim se janë çështje serioze edhe në këtë Komision i kemi. Ministër domethënë faktikisht është te ai Komiteti atje që u tha, nuk e keni ju kompetencë, por na do të kërkojmë, që me strategjinë e energjisë ne me ditë strategjinë afatgjate të menaxhimit të linjtit. A ka Kosova ma llogari me shkuar me shumë megavat e me djeg apo duhet të shkojmë në kimizim me këtë teknologjinë që pjesërisht është me këto dy projekte, apo duhet me shti turshi, edhe me thënë ska as njëra as tjetra, pe lejmë nuk po e shfrytëzojmë thëngjillin edhe po rrijmë në vend. Për me marrë këtë vendim, nuk mundemi ne me marrë me hamendje por duhet me pasë

studime me bërë eksplorime, hulumtime multidisiplinare të mundësive të shfrytëzimit të thëngjillit, në këtë drejtim kjo kishte me qenë ma korrekte. Sa i përket kësaj ne si Komision kemi pru qëndrime shumë rigorozë për zbatimin e atij projekti. Qeveria mirë ka bërë që e ka tërheq, ne duhet të shohim tash çka duhet me bërë me të, edhe duhet t'i shohim dimensionet e tij, pasojat e tij, hulumtimet duhet me i pasë. Përgjegjësinë duhet me marrë kjo shoqëri se çka dëshiron të bëjë me këtë qymyr. Sot në tërë botën është në fazën e eksplorimit fazën e projekteve pilot. Unë pajtohem me atë që është më e ndjeshme në Kosovë sepse është dendësia e popullsisë, rreziku i ujërave nëntokësore, krejt këto duhet me i eksploru. Nuk mundemi me mbyll derën ne, që çdo investitori me i thënë jo nuk bënë, ne duhet me i marrë vendimet në mënyrë të informuar, ajo çka ka kerku ky Komision është studimi i fizibilitetit edhe të flasim në mënyrë të argumentuar, edhe kemi bërë shumë vërejtje në atë që ka ardhë, edhe në atë që ka ardhë prej Ministrisë janë cekur shumë rreziqe, nuk është që janë fshehtë rreziqet. Unë kërkoj prej Qeverisë edhe Komisioni ta trajtojnë, ne duhet me bërë me strategji a pe shfrytëzojmë këtë thëngjill, qysh pe shfrytëzojmë këtë thëngjill ose po vendosim mos me e shfrytëzu hiq, gjeneratat e ardhëshme bëhen më të menqur edhe e shfrytëzojnë. Këto janë tri alternativa. Konkludojmë tash, të mundohemi të i përmbledhim disa sugjerime për Ministrin prej diskutimit. Unë po mundohem me e përmbledhë: 1. Ne e mbështesim raportimin e Ministrisë edhe e inkurajojmë me vazhduar me zbatimin e këtyre projekteve domethënë gjithashtu mendoj se kishte kërkesa që sa më shpejt të vjen strategjia e energjisë, të vjen ligji për ndërmarrjet publike kur të bëhet, vijnë raportet për minierat që ti analizojmë të gjitha këto çështje; 2. Meqenëse u pajtu edhe Ministri, sugjerojmë që të bëhet që ky grupi për zbatimin e ligjit për Trepçën përfshirë të gjithë aktorët që u përmenden, mos me pritë ne strategjinë se shumë sende mund të bëhen, mund të bëhet statuti, ka shumë sende që duhet me punu në mënyrë që mos të krijojmë hapësirë atje; 3. Raporti i performancës për ndërmarrje publike të vjen sa ma shpejtë në procedurë sepse është viti 2016 në fund a raportin për 2015 nuk e kemi trajtu, edhe të jetë më gjithë përfshirës edhe të vlerësojë performancën, kjo gjë kërkohet me ligj. Pjesë përbërëse e këtij raporti duhet të jetë edhe zbatimi i kontratave për privatizimin apo koncesionimin e ndërmarrjeve publike, duhet me pa sa janë zbatu ato kontrata. Ne duhet me ditë sa është kontributi i LIMAK-ÇALIKUT në buxhet, sa paguan në vit, e dyta sa ka bërë investime qysh ka bërë investimet. Me kontratë parashihet me qenë atje një njësi për monitorim të kontratës, nuk di ku, a në ministri te ju a ku. Kontrata është 20 vjet a pe zbaton ai ne duhet ta shohim. Ju lutem kontratat i keni edhe me i përfshi në raport ose në këtë raport ose në raport të veçantë; 4. Ndërlidhja e studimeve Kosova A, Kosova B, dhe TAP, ministri na dha përgjigje, por për neve është shumë me rëndësi që në kuadër të energjisë të shohim menaxhimin e GAP-it që mundet me na ndodhë në furnizimin me energji, besoj që do ta kemi në strategji; 5. Edhe kjo që thamë marrëdhëniet ekonomike me Serbinë, aspekti i Kodit, aspekti i KOSTT-it, aspekti i shumë çështjeve tjera, që na duhet të ndërtojmë një politikë shtetërore me Serbinë, edhe me i mbrojte interesat tona ekonomike pa marrë parasysh kur kryhen negociatat a zbatohen marrëveshjet ne duhet me i mbrojte interesat ekonomike. A mund të përfundojmë kështu. Ju falemnderit shumë.

Përgaditi:

Njësia mbështetëse e Komisionit